

KONTRATË THEMELIMI
E SHOQËRISË SË THJESHTË
“CENTURY 21 ASTORIA”

NENI 1
FORMIMI

Sot më datë 04 / 01 / 2021 themeluesit që firmosin më poshtë:

Z. Fisnik Haçkaj, shtetas Gjerman me zotësi te plote për të vepruar, e lindur me 05.07.1980 ne Tirane, me nr letërnjoftimi L7JV13F5J.

Z. Florjan Haçkaj, shtetas Gjerman me zotësi te plote për të vepruar, e lindur me 17.07.1983 ne Tirane, me nr letërnjoftimi L7JV19FC5.

Ne baze te Ligjit 9901 dt 14.04.2008 „Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare „, si dhe Ligji 9723 dt 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit “ themelojmë me vullnet te lire shoqërinë e thjeshtë, me emërtim **“CENTURY 21 ASTORIA”**

NENI 2
SELIA

Selia e shoqërisë së thjeshtë **“CENTURY 21 ASTORIA”** është ne rrugën “Teodor Keko”, Zona Kadastrale 3866, nr pasurie 306/375-N55 , Yzberish Tiranë. Shoqëria ka te drejte te hape filiale ne te gjithë vendin.

NENI 3
KOHEZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë se shoqërisë së thjeshtë **“CENTURY 21 ASTORIA”** është pa afat nga momenti i regjistrimit te saj pranë QKB Tiranë.

NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë **“CENTURY 21 ASTORIA”** është:

1. Agjenci imobiliare. Krijim, zhvillim, zyra ndërmjetësimi për pasuritë e paluajtshme nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate te veçante Franchising, aktivitet ndërmjetësimi për pasuritë e paluajtshme.
2. Aktivitet ne fushën e pasurive të patundshme, vlerësimin e pasurive të patundshme, të angazhohet në shitjen me shumicë dhe pakicë të çdo lloj pasurie dhe të hap dyqane, degë apo zyra po të jetë e nevojshme për arritjen e qëllimit të shoqërisë. Menaxhim dhe administrim pronash dhe objekteve. Administrimin e bashkëpronësisë në prona dhe ndërtesa. Për dhënien me qira, nën qira të ambienteve të ndryshme.
3. Aktivitet në fushën e projektimit të godinave civile, mirëmbajtje dhe restaurim të objekteve të ndryshëm.
4. Organizimi i eventeve, panairove, publikime, reklama dhe fushata reklamuese, si dhe organizim tjetër artistik dhe televiziv të çdo forme.

5. Konsulencë financiare, ekonomike, juridike që ka lidhje me biznesin, me aktivitetet të ndryshme tregtare të personave fizik dhe juridik përfshire institucione financiare dhe ato shtetërore.
6. Ndërmjetësim në lidhje me shitje të produkteve të ndryshme.
7. Investime ne fushën e ndërtimit dhe tregtimit brenda dhe jashtë vendit të pasurive te pa luajtshme.
8. Transportim mallrash , shërbime te ndryshme te lidhura me këtë aktivitet.

NENI 5 KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali fillestar i shoqërisë “CENTURY 21 ASTORIA” është **100.000 leke** dhe i ndare ne 2 kuota me kontributin e ortakëve si më poshtë:

1. Një kuotë **Fisnik Haçkaj** ne masën 50 % (pesëdhjetë për qind) të kapitalit themeltar.
2. Një kuotë **Florjan Haçkaj** ne masën 50 % (pesëdhjetë për qind) të kapitalit themeltar.

Kapitali fillestar është i nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga ortakët themelues, ai mund të ndryshojë sipas vendimit që mund të marrin ortakët.

NENI 6 ORGANET E SHOQERISE DHE ASAMBLEJA

Organet drejtuese te shoqërisë “CENTURY 21 ASTORIA” janë:

- Asambleja e Ortakëve ,organi më i lartë vendim marrës
- Administrator është **Z. Fisnik Haçkaj**, me numër letërnjoftimi L7JV13F5J. Kohëzgjatja e administratorit është 5 vjet, **deri 04/01/2026**.

NENI 7

Organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizik e juridike, vendas apo te huaj , shprehen ne statut që bashkë me kontratën themelimit janë dokumentet bazë të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e marrëdhënieve në këtë shoqëri.

NENI 8

Veprimtarinë e saj, shoqëria do të zhvilloje në përputhje me legjislacioni Shqiptar.

NENI 9

Te gjitha mosmarrëveshjet me persona fizike ose juridik si dhe me organet shtetërore zgjidhen me mirëkuptim , me ane te dispozitave te këtij akti ,statuti edhe legjislacioni shqiptar dhe kur këto mjete nuk japin rezultat atëherë zgjidhen me Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo kontrate themelimi hyn ne fuqi ditën e regjistrimit te shoqërisë së thjeshtë “CENTURY 21 ASTORIA” në QKB në këtë dite shoqëria “CENTURY 21 ASTORIA” njihet si person juridik

ORTAKËT THEMELUES

Fisnik Haçkaj

Florjan Haçkaj